

TRASHËGIMIA SHPIRTËRORE E TIRANËS NË MUZIKË

Vasil S. Tole

Tiranë: Mediaprint (2020, ISBN 978-9928084347)

Trashëgimia shpirtërore e Tiranës në muzikë ka si objekt muzikëbërjen tradicionale në Tiranë. Autori vëren që në fillim se për Tiranën është shkruar pak sidomos në rrafshin muzikor (fq. 11). Si rrjedhojë, ai merr përsipër të jetë sa më gjithpërfshirës dhe gjithashtu deskriptiv sa i takon fenomeneve që kanë gjalluar historikisht në qytetin e Tiranës. Këto ai i përfshin në suazën e trashëgimisë shpirtërore në muzikë (intangible cultural heritage), e njohur si e tillë përmes UNESCO-s dhe politikave shtetërore mbi kulturën. Me këtë trashëgimi, Vasil Tole ka parasysh: praktika muzikore të ndryshme, rituale, përfaqësues dhe figura të përveçme, instrumente si dhe formacione instrumentale e vokale dhe repertore e gjini karakteristike. Libri ndahet në pesë pjesë kryesore dhe është i pajisur me një CD me regjistrime tingulllore. Pjesa e parë, bën bashkë aspekte të natyrës historike me analiza etnomuzikologjike mbi veglat

popullore tradicionale, muzikën vokale dhe veçoritë e secilës. Një kapitull i përveçëm i kushtohet ritualit të dasmës, si rituali qendror në jetën tradicionale të qytetit, nga i cili veçon repertoret dhe gjinitë kryesore muzikore. Në pjesën e dytë njihemi me artistët dhe formacionet muzikore që kanë formësuar muzikën popullore gjatë dy periudhave kryesore historike, para dhe pas Luftës së Dytë botërore. Në vëmendje të dinamikave historike janë edhe lidhjet me qendra të tjera urbane, nga të cilat spikasin sidomos lidhjet me Elbasanin dhe Shkodrën. Një rol të rëndësishëm, Tole iu mvesh edhe përfaqësuesve të muzikës me saze, të Shqipërisë së jugut, të cilët duke u vendosur në Tiranë, integrohen në mënyrën e tyre brenda jetës urbane të qytetit. Edhe Muhamet Gurra, pa dyshim, figura më e rëndësishme për muzikën tradicionale tiranase, zë vend të përveçëm në këtë histori. Ndërkaq, në kapitullin dedikuar muzikës në Tiranë - Luftës së Dytë Botërore

kish qenë e nevojshme që autori të ishte zgjeruar edhe pak më shumë sa i takon rolit që politikat shtetërore luajtën në këtë drejtim. Pjesa e tretë paraqitet si një një lloj udhërrëfyesi për materialet të cilat gjenden në CD-në bashkëngjitur dhe që përbajnjë 19 regjistrime tingullore të repertorit muzikor të Tiranës dhe të interpretuesve më të spikatur të tij. Është për t'u vlerësuar zgjedhja e autorit për t'i marrë në konsideratë këta interpretues përmes materialeve tingullore të regjistruara, duke i profilizuar dhe gjithashtu duke analizuar materialin e përzgjedhur. Kjo pasi materia tingullore është e dhëna parësore bazë. Edhe pse, në parim flasim për një trashëgimi shpirtërore, e kemi të nevojshëm materialitetin e saj fizik. I ndërgjegjshëm për këtë paradoks, autori zgjedh ta kapërcejë duke na vendosur në kontakt me tingullin dhe dëgjinin. Ndërsa pjesa e katërt, mund të konsiderohet si një material shtesë sa i takon folklorit gojor të Tiranës (përfshin fjalë të urta dhe gjëegjëza të mbledhura nga folkloristët), pjesa e pestë ofron 93 transkriptime melodish tradicionale për të cilat do kishte qenë e udhës që të

vendosej edhe autori i tyre. Gjithsesi, këto përplotësojnë regjistrimet tingullore, si pjesë e një tradite të konsoliduar transkriptimesh muzikore në etnomuzikologjinë shqiptare.

Pra, libri bën bashkë analiza etnomuzikologjike, me aspekte historiografike dhe gjithashtu biografirafik. Biografitë e mjeshtreve dhe interpretuesve e pasurojnë aspektin historiografik sa i takon shkallës së agjensisë të tyre në realitetin muzikor të kohës kur vepruan. Gjithashtu, pavarësisht se fokusi kryesor ngelet qyteti, autori e zgjeron gjeografinë e praktikave edhe me zonat rurale rrthepranë, të cilat kanë luajtur rol të rëndësishëm në “tesitura” muzikore urbane të Tiranës.

Vëllimi sjell edhe një lexim sasior të bibliografisë rrëth temës, sikundër paraqitet mjaft i pasur në referencat arkivore, sidomos ato tingullore. Vëmendje të posaçme autori i ka kushtuar jo vetëm arkivave, por edhe regjistrimeve tingullore që janë bërë kohë pas kohe dhe që sot përfaqësojnë një të dhënë po aq të vlefshme dokumentare, sa edhe regjistrimet arkivore, apo ato të Radio Tiranës. Në këtë vëllim,

treguar një vëmendje e posaçme edhe ndaj aspekt vizual e ikonografik të muzikës, përcjellë nëpërmjet një sërë fotografish, riprodhime veprash pamore nga artistë të cilët janë fryshtuar nga muzika e qyteti. Të gjitha të marra së bashku e pasurojnë ndjeshëm tekstin edhe nga ana vizuale.

Harku kohor në të cilin është vendosur libri është ai i 100 viteve të fundit (1920-2020). Ky shekull shënon ekzistencën e Tiranës si kryeqytet i vendit, por, mbi të gjitha, karakterizohet edhe nga një sërë procesesh thelbësore e transformuese që kanë të bëjnë me kalimin nga një rend tradicional shoqëror që ka ciklet e traditat e veta, drejt modernitetit dhe realiteteve dinamike që ai

krijon në jetën urbane e nationale; kalimi nga kuadri ritual, drejt atij shekullar dhe, më në fund, nga formatet përgjithësisht inkluzive të muzikëbërjes ku dallimet mes interpretuesit dhe dëgjuesit nuk ekzistojnë, në ato ekskluzive të regjistrimeve radiofonike e të interpretimeve skenike. Në këtë libër, përshkruhen pikërisht dukuritë dhe protagonistët që jetuan gjatë këtyre proceve transformuese. Kësosoj, duke qenë të ndërgjegjshëm për këtë fakt, *Trashëgimia shpirtërore e Tiranës* mund të lexohet edhe si një lloj mapëzimi i detajuar i cili, hap shtigje të shumta për të hulumtuar në të ardhmen.

Mikaela Minga